



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

Bashkia Lezhë, L. "Skënderbej", Sh. "Gjergj Kastrioti", 4501 Lezhë, Nr. Tel. 00355 215 22270, e-mail: [f.frokaj@lezha.gov.al](mailto:f.frokaj@lezha.gov.al)

**V E N D I M**

Nr. 205, Datë 28 / 10 / 2016

**Për**

**Miratim shpërblimi, për 18 maturantët më të mirë të vitit 2016**

Në mbështetje të nenit 54, të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit Nr.8399, datë 09.09.1998 "Për Buxhetin Lokal", i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit Nr.147/2015 "Për Buxhetin e vitit 2016", të Udhëzimit M. Financave Nr.1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e Buxhetit për vitin 2016", dhe të V.K.B Nr.148, datë 06.06.2016 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2016", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkisë;

**V E N D O S I :**

**I.** Miratimin e masës së shpërblimit prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo maturant me notë mesatare mbi 9.<sup>5</sup> të maturës shtetërore 2016. Ky shpërblim do të jepet për 18 maturantë sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

**II.** Për përballimin e këtij shpenzimi, të përdoret fondit rezervë në shumën 900.000 lekë. Për këtë të kryhen veprimet në Gr.00 Prog.01110 Kap.05 Art/llog.ek.606 për shumën 900.000 lekë.

**III.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT  
Gjok NDOKA**



Nr. \_\_\_\_ Prot, Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2016

Kryetarit të Bashkisë Lezhë  
Prefektit të Qarkut Lezhë  
Arkivës së Bashkisë  
Degës së Thesarit Lezhë

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Jerina VATAJ**